



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2043/3 Prot.

Vlorë më, 18. 08. 2025

VENDIM

Nr. 61, datë 18.08.2025

**PËR SHPËRBLIM NGA FONDI I VEÇANTË
I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika 1, shkronja rr, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, nenit 7 të VKM-së nr. 493, datë 06. 07. 2011 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 929, datë 17. 11. 2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", propozimit të Administratorit ardhur me shkresën nr.1681/4 prot, datë 05.08.2025, duke marrë në konsideratë përfundimin e marrëdhënies së punës me znj. Luljana Grabovaj, për shkak të paafësisë së përhershme për punë dhe vjetërsinë në punë prej 14 vitesh në UV, si dhe efektet financiare të përlllogaritura dhe mbuluara nga fondi i veçantë për vitin 2025, në mbledhjen e datës 18.08.2025 Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërblimin për vjetërsi në punë për znj. Luljana Grabovaj, në masën e 7 pagave mujore, në vlerën totale prej 372,400 (treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekësh, për 14 vite të plota pune në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë
2. Efekti financiar i këtij vendimi do të përballohet nga fondi i veçantë i Buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për vitin 2025.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Burimeve Njerëzore, Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Administrative në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

